



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:201143

Datë: 15.11.2022

Numri i dokumentit: 03647973

C.nr.1012 /2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtares Mirvete Alidema, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Abdyli, në çështjen kontestimore të paditësit K...R...i K..., (në vijim KRK) Sh.p.k. P..., kundër të paditurës H.K nga Gj..., Rruga "M...I...", me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 15 Nëntor 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar e arritur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjilan, me numër të referencës Nd.nr.94/2022, e arritur në gjykatë më datë 14.11.2022, në çështjen kontestuese sipas numrit C.nr.1012/2022, të paditësit K..R...K.-Sh.p.k me seli në P..., e ushtruar ndaj të paditurës H.K nga Gj..., për shkak të kompensimit të dëmit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi më datën 30.09.2022, kundër të paditurës H.K nga Gj..., për shkak të kompensimit të dëmit.

Bazuar në natyrën e kontestit kjo gjykatë ka vlerësuar se kjo lëndë mund të jetë e përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit, andaj në pajtim me nenin 8 të Ligjit Për Ndërmjetësimin Nr.06/L-009, me datën 31.10.2022, këtë çështje kontestuese, gjykata e ka referuar në Qendrën e Ndërmjetësimit.

Qendra e Ndërmjetësimit në kuadër të Gjykatës Themelore në Gjilan me datë 15.11.2022, kësaj gjykate i ka dërguar Marrëveshjen për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar në mes palëve ndërgjyqës me numër të referencës Nd.94/2022, të datës 14.11.2022 për aprovim.

Gjykata konstaton faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim, i plotëson kushtet ligjore për tu aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirish mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit.

Lidhur me shpenzimet gjykata vendosi në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim.

Nga të cekurat më lartë, e në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, neni 15 paragrafi 1 dhe neni 19 paragrafi 1 të Ligjit Për Ndërmjetësim si dhe në pajtim me nenin 3 paragrafi 3 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitën të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.1012/2022, me datë 15 Nëntor 2022

Gjyqtarja,
Mirvete Alidema

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.